



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

V E N D I M

Nr. 65, Datë 05/06/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 42, datë 03.05.2019, e Z. M. Z., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore”¹, “racës”² dhe “gjendjes ekonomike”, nga ana e KMCAP Epror dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se ne datën 23.11.2017, Z. M. Z. ka kryer operacion Bay Pass, në zemër në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. Pas daljes nga spitali është trajtuar për 6 muaj me raport paaftësie të përkohëshme në punë dhe në vijim mjeku që e ndiqte gjendjen e tij shëndetësore, i ka dhënë fletëdaljen me diagnozën përkatëse dhe Fletëdrejtimin për në KMCAP Korçë. Ankuesi e informon Komisionerin se më parë ai ka punuar si i vetëpunësuar dhe ka derdhur kontribut pranë sigurimeve shoqërore për pothuajse 25 vjet, të cilat ka ndalur së derdhuri në prill të vitit 2013, pasi nuk është lejuar më të tregëtojë në tregun, ku ai punonte. Z. M. Z. është paraqitur pranë KMCAP Korçë, ku i është refuzuar e drejta për të përfituar kemp, në bazë të

¹ Referuar aktit Epikrizë dalje të lëshuar nga QSUT, ankuesi ka kryer ndërhyrje në zemër.

² Referuar vërtetimit të lëshuar nga Shoqata “Qendistaret”, Korçë, rezulton se ankuesi i përket komunitetit egjiptian.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

parashikimit të pikës 2, të nenit 35, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, (të ndryshuar), ku parashikohet: “*Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror*”. Në vijim, ankuesi është ankimuar pranë KMCAP Epror në Tiranë, ku sërish i është refuzuar kemp, duke u mbështetur në të njëjtin arsyetim, sikurse KMCAP Korçë.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se ai ka derdhur kontribut të plotë të sigurimeve shoqërore përgjatë vitit 2012, si dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2013. Z. M. Z. pretendon se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë nuk ka përlllogaritur saktë periudhën përgjatë së cilës ai ka derdhur kontribut për sigurimet shoqërore, ndërkohë që mbështetur në të tilla përlllogaritje të pasakta, KMCAP Korçë dhe KMCAP Epror kanë vendosur, që ai të mos përfitojë kemp. Në këto kushte, Z. M. Z. pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, racës dhe gjendjes së tij ekonomike.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 42, datë 03.05.2019, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7⁴, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) Epror, Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Korçë, me shkresën nr. 672/1/1, datë 10.05.2019⁵, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:

⁴ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “*Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër*”.

⁵Shkresa nr. 672/1/1, datë 10.05.2019, e KMD-së iu dërgua për dijeni edhe KMCAP Korçë dhe ankuesit M. Z..

- Kopje të Vendimeve të KMCAP Korçë dhe KMCAP Epror, Tiranë, nëpërmjet së cilëve Z. M. Z. i refuzohet kempit;
- Data e saktë, kur ankuesi ka aplikuar për herë të parë pranë KMCAP Korçë, për përfitim kempit. Të dërgohet një kopje e aplikimit/kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga ankuesi;
- Data e saktë, kur ankuesi ka ankimuar vendimin e KMCAP Korçë, pranë KMCAP Epror, Tiranë. Të dërgohet kopje e ankimit;
- Të përcaktohet saktësisht momenti i lindjes së të drejtës për ankuesin për të përfituar kemp;
- Të përcaktohen saktësisht, se cilat janë 5 vitet e fundit, para lindjes së të drejtës së ankuesit për të përfituar kemp, brenda së cilëve, ai duhej të kishte patur së paku 12 muaj sigurim shoqëror;
- Vërtetim, ku të pasqyrohet periudha e plotë përgjatë së cilës, Z. M. Z. ka derdhur kontribute për sigurimet shoqërore.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 672/1/1, datë 10.05.2019, së Komisionerit, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë, dërgoi shkresën nr. 5176, datë 15.05.2019, nëpërmjet së cilës e informon KMD-në, se Z. M. Z. ka dorëzuar dokumentacionin përkatës për të përfituar pension invaliditeti, nëpërmjet kërkesës së tij nr. 450, datë 30.03.2018, depozituar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë. Pas komisionimit, me Vendimin nr. 924, datë 16.04.2018, të KMCAP Korçë, është vendosur që Z. M. Z. të jetë “*pa grup*”, pasi ai nuk përfiton në bazë të nenit 35, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar). Referuar këtij vendimi, data e fillimit të invaliditetit për ankuesin, është 06.10.2017. Në vijim, në datën 08.05.2018, Z. M. Z. ka ankimuar Vendimin nr. 924, datë 16.04.2018, të KMCAP Korçë, pranë KMCAP Epror, i cili ka vendosur nëpërmjet Vendimit nr. 333, datë 23.08.2018, të lërë në fuqi vendimin e sipërpërmendur të KMCAP Korçë⁶. Mbështetur në nenin 39/1/3, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), Vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë.

Në shkresën e mësipërme, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë e bën me dije Komisionerin, se 5 vitet e fundit përgjatë së cilëve kërkohen 12 muaj kontribut për sigurimet shoqërore, për ratin e ankuesit, i përkasin periudhës 07.10.2012 – 05.10.2017. Sipas dokumentacionit që administrohet në dosje, për Z. M. Z. janë llogaritur 24 vjet 10 muaj vjetërsi pune gjithësej. Për periudhën 07.10.2012 – 05.10.2017 janë llogaritur 2 muaj, 24 ditë,

⁶ Pika 2, e nenit 35, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), parashikon: “*Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç dhe në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror*”.

kontribute të derdhura në sigurime shoqërore nga ana e ankuesit. Bashkëlidhur shkresës nr. 5176, datë 15.05.2019, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë ka dërguar periudhat e vjetërsisë në punë, si dhe kopje të akteve, që KMD kishte kërkuar nëpërmjet shkresës nr. 672/1/1, datë 10.05.2019.

2. Në vijim, ankuesi M. Z. dërgoi me e-mail, pranë KMD-së, kërkesën e datës 27.05.2019, nëpërmjet së cilës kërkon të tërheqë ankesën e tij kundër e KMCAP Epror dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë.

PËR KËTË ARSYE:

Mbështetur në nenin 94, pika 1, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 42, datë 03.05.2019, e Z. M. Z., pasi ky i fundit ka depozituar pranë KMD-së, kërkesë për tërheqje të ankesës.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Fusha – te mira dhe sherbime
Shkak – gjendja shendetesore, raca, gjendja ekonomike